

VENDIM
Nr.42, datë 12.1.2011

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES HIDROKARBURE SHITESË TË KONTRATËS ME
NDARJE PRODHIMI, NDËRMJET MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE
ENERGJETIKËS (MË PARË E NJOHUR SI MINISTRIA E INDUSTRIËS DHE ENERGJETIKËS)
SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA AGJENCIA KOMBËTARE E
BURIMEVE NATYRORE, DHE ISLAND INTERNATIONAL EXPLORATION B.V. E BEACH
ENERGY LIMITED, PËR BLLOKUN “DURRËSI”
(NË DET), SHQIPËRI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 e 13 të ligjit nr.7746, datë 28.7.1993 “Për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi)”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e marrëveshjes hidrokarbure shtesë të kontratës me ndarje prodhimi, ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (më parë e njohur si Ministria e Industrisë dhe Energjetikës) së Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, dhe Island International Exploration b.v. e Beach Energy Limited, për bllokun “Durrësi” (në det), Shqipëri, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha